



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 199 Akti

Nr. 276 Vendimi
Tiranë, më 21.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi Kryesuese
Lulzim Hamitaj Relator
Olsi Komici Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 15.7.2020, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Irena Brahimi**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Gjirokastrër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila në seancën dëgjimore publike, të datës 15.7.2020, kërkoi konfirmimin e saj në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Znj. Irena Brahimi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të informacioneve të Klasifikuara (në vijim DSIK); dhe pranë (ish) Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD).
- ii. Pika 4 e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “*Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio*”. Në këto kushte, ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 17.9.2018, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici.
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe studioi të tre raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 – 44, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 24.9.2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohej kryesuesi i trupit gjykues, komisionere Brunilda Bekteshi. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- v. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit, znj. Irena Brahimi, në datën 24.6.2020, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tri kriteret e rivlerësimit të parashikuar nga ligji nr. 84/2016.
- vi. Në datën 25.6.2020, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht - duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të

provuar të kundërtën - për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.

- vii. Pasi u njoh me dosjen, subjekti i rivlerësimit paraqiti brenda afatit të caktuar shpjegimet e shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- viii. Në datën 14.7.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 15.7.2020, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin, znj. Irena Brahimi ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, të cilat i ka paraqitur edhe me shkrim, së bashku me dokumentacion provues.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 15.7.2020 u mbyll, për të rifilluar më 21.7.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ); (dh) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (e) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve të paraqitura në seancën dëgjimore; dhe (ë) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-JA

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar pasuritë, si vijon:

1. apartament banimi me sip. 87 m², ndodhur në Rr. “****”, lagjja nr. ***, p. ***, Sarandë;
2. truall me sip. 200 m², ndodhur në ***, Sarandë;
3. apartament banimi me sip. 95.3 m², ndodhur në Gjirokastër;
4. automjet “Mercedes Benz” tip Daimler Chrysler C 220 CDI, me targa ***, viti i prodhimit 2000;
5. llogari bankare në “Alpha Bank”, në emër të bashkëshortit, z. A. B., në vlerën 40.018 euro;
6. llogari rrjedhëse në “Societe Generale Albania” në GBP, në emër të shtetasve A. dhe Irena Brahimi në shumën 13.46 GBP;
7. llogari rrjedhëse e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi në “Societe General Albania”, në shumën 23.124 lekë;
8. llogari bankare në “Raiffeissen Bank” në emër të z. A. Brahimi, në shumën 2.61 euro;
9. llogari bankare rrjedhëse e bashkëshortit A. Brahimi, në BKT, në shumën 3.170 lekë;
10. llogari bankare në “Lloyd Bank”, Londër, Mbretëri e Bashkuar, në shumën 577.05 GBP, në emër të vajzës së subjektit, znj. E. B.

A/2. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

1. **Apartment banimi me sip. 87 m², ndodhur në Rr. “****”, lagjja nr. ***, p. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Sarandë, në të cilën subjekti i rivlerësimit zotëron 1/5 pjesë.**

1. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në deklaratën e interesave periodike private (në vijim DIPP) të vitit 2003, si dhe më pas në deklaratën *Vetting*, të përfituar me anë të privatizimit, në bazë të ligjit nr. 7652/1992¹, mbi të cilën zotëron 1/5 pjesë të kësaj pasurie, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë: Rr. “****”, lagjja nr. ***, p. ***, Sarandë.
2. Kjo pasuri ka rezultuar se është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.5.1993², të lidhur midis Ndërmarrjes Komunale Banesa Sarandë dhe blerësit z. S. P., kundrejt vlerës 17.892 lekë.
3. Në vijim të kërkesave të përcjella nga Komisioni, ASHK Sarandë është përgjigjur me shkresën nr. *** prot., datë 3.10.2019³, duke konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, dhe bashkëpronarëve të tjerë të kësaj pasurie, rezulton i regjistruar apartamenti me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.
4. Gjithashtu është administruar certifikata për vërtetimin e pronësisë, e lëshuar më 7.4.2003 dhe kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe 87 m², me adresë: lagjja nr. ***, p. ***, shk. ***, ap. ***, Sarandë, ku nga kjo pasuri rezulton e regjistruar në emër të bashkëpronarëve S., K., K., Ll. dhe I. P..
5. Komisioni, pasi ka konstatuar përputhjen e deklarimeve të subjektit mbi këtë pasuri, si dhe duke mbajtur në konsideratë jo vetëm periudhën e privatizimit në fjalë (viti 1993), por edhe shumën e papërfillshme - në raport me tërësinë e vlerësimit të pasurive - me të cilën është blerë pasuria në fjalë, ka konkluduar për mospasje të problematikave lidhur me të.
 2. **Truall me sipërfaqe 200 m², ndodhur në ***, Sarandë**, me vlerë 500.000 lekë, përfituar me kontratën e shitblerjes në vitin 1996.
6. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003, si dhe më pas në deklaratën *Vetting*. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 nga kursimet familjare të subjektit dhe të bashkëshortit, ndërsa në deklaratën *Vetting* është deklaruar nga të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit dhe i prindërve të saj.
7. Ky truall është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.2.1996, me çmim blerjeje në vlerën 500.000 lekë⁴, nga ku rezultojnë si palë shitëse shtetasit J. Rr. (L.) dhe L. L., ndërsa si palë blerëse bashkëshorti i subjektit, z. A. B. Gjithashtu, ka rezultuar se pasuria në fjalë ende nuk është pajisur me certifikatën e pronësisë.
8. Përgjatë hetimit administrativ është administruar dokumentacioni, si vijon:
 - a. nga ZQRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 28.5.2018, është bashkëngjitur përgjigjja e ZVRPP-së Sarandë nr. *** prot., datë 18.5.2018, në të cilën është

¹ Kjo pasuri është regjistruar me mbiemrin e vajzërisë “P.”, referuar certifikatës për vërtetimin e pronësisë, lëshuar më 7.4.2003.

² Kontrata e shitjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 17.5.1993, ndërmjet EKB-së dhe z. S. P.

³ Në përgjigje të kërkesës nr. *** prot., datë 18.9.2019, dërguar nga KPK-ja.

⁴ Referuar kontratës së shitblerjes, kjo shumë i është dorëzuar palës shitëse përpara lidhjes së kontratës.

- konfirmuar se bashkëshorti, z. A.B., ka të regjistruar pasurinë e paluajtshme të llojit truall⁵, me sip. 200 m², në librin ***, f. ***, nr. *** indeksi, datë 20.11.2002;
- b. vërtetim hipotekor lëshuar më 21.3.2013, për pasurinë e paluajtshme të llojit truall, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, f. ***, nr. *** indeksi, datë 20.11.1996, në z. k. ***, me sip. 200 m², në emër të z. A. B.;
- c. kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.2.1996 lidhur ndërmjet palës shitëse J. Rr. (L.) dhe L. L. dhe palës blerëse A. B., plan vendosje dhe plan rievimi datë 14.2.2011.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

9. Komisioni ka kryer analizën financiare bazuar në dokumentacionin e administruar përgjatë hetimit administrativ, përfshirë këtu edhe atë të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimet e deklaruara për këtë pasuri deri në shkurt të vitit 1996, periudhë në të cilën rezultoi të jetë kryer blerja e pasurisë në fjalë, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj, për periudhën janar 1995⁶ - janar 1996, kanë realizuar të ardhura në vlerën monetare prej 62.652 lekësh⁷. Gjithashtu, në bazë të dokumentacionit të administruar nga institucionet përkatëse⁸ është konstatuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka filluar punë në tetor të vitit 1997, pra, pas realizimit të blerjes së pasurisë në fjalë.
10. Nëpërmjet pyetësorit nr. 6, të datës 21.1.2020, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar nga Komisioni, paraqitja e aktit të martesës⁹ nga ku – pas administrimit – rezultoi se ka lidhur martesë ligjore me shtetasin A. B. në datën 5.12.1995. Për rrjedhojë, pasuria e paluajtshme është blerë rreth dy muaj pas martese.
11. Lidhur me burimet e mundshme financiare nga kursimet e prindërve të subjektit të rivlerësimit – të cituar si një nga burimet në deklaratën *Vetting* – Komisioni i ka kërkuar subjektit, nëpërmjet pyetësorit nr. 7, që të specifikonte në terma sasiorë vlerën e këtij burimi, si dhe të paraqiste dokumentacion ligjor për t'i provuar ato.
12. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 7, ka shpjeguar se gjysma e çmimit të blerjes së kësaj pasurie është paguar nga bashkëshorti me të ardhurat e tij përpara martese dhe ka informuar se këto të ardhura i ka krijuar nga punësimi përgjatë periudhës korrik 1992-gusht 1993 në shtetin grek. Gjysma tjetër e çmimit është paguar përkatësisht në vlerën 200.000 lekë nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga punësimi në Shqipëri dhe Greqi, si dhe në vlerën 50.000 lekë nga prindërit e saj, të realizuara nga të ardhurat e tyre nga punësimi dhe pensionet.

⁵ Pasuria e llojit truall, blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, është përfituar më parë nga shtetasit J. dhe L. Rr., me vendimin e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. ***, nr. ***, të ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 4.4.2004, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për ripozionimin e kufijve. Në vendimin nr. *** akti dhe nr. ***, datë 19.9.2003, f. ***, gjykata ka krijuar bindjen se veprimi juridik i kryer me vullnetin e palëve sipas kontratës së shitjes datë 26.3.1996 është kryer me vullnetin e plotë të palëve. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të shtetasve K. dhe I. L.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë konfirmon se subjekti ka filluar punë si nd/gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë më 15.2.1996. Më parë, ka qenë e punësuar te Këshilli i Rrethit.

⁷ Sipas vërtetimit nga ISSh-ja, të ardhurat për vitin 1995 kanë qenë në shumën 56.895 lekë, ndërsa të ardhurat për janar 1996 kanë qenë në shumën 5.757 lekë.

⁸ Me vërtetimin nr. *** prot., datë 13.10.2016, ISSh-ja dega Sarandë konfirmon se shtetasi A. B. ka filluar marrëdhënien e punësimit si mjek i përgjithshëm në tetor të vitit 1997.

⁹ Akti i martesës u kërkuar me qëllim identifikimin e periudhës së saktë të lidhjes së martesës ligjore për përcaktimin e periudhës kohore për krijimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara si burim financiar për blerjen e truallit në ***, Sarandë.

13. Gjithashtu, Komisioni kreu një hetim të pavarur mbi këtë rrethanë, duke iu drejtuar me kërkesa institucioneve kompetente, si vijon:
14. Me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2020, Komisioni iu drejtua ISSh-së Gjirokastër, duke i kërkuar informacion lidhur me të ardhurat e realizuara për periudhën 1991 – 1996, nga prindërit e subjektit dhe të bashkëshortit të saj.
15. Drejtoria Rajonale Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2020, informoi se informacioni i kërkuar duhet t'i drejtohet DRSSH-së Vlorë, për prindërit e subjektit të rivlerësimit. Ndodhur në këto kushte, Komisioni iu drejtua institucionit përkatës, ISSh-së Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2020 (për prindërit e subjektit të rivlerësimit). Kjo e fundit ka bërë me dije me shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2020 se ky informacion do të vihej në dispozicion nga DRSSH-ja Sarandë, e cila dërgoi informacionin me shkresën nr. *** prot., datë 4.6.2020, nga ku ka rezultuar se të ardhurat e realizuara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, Spiro dhe Kostando Papa, deri në shkurt të vitit 1996 kanë qenë në shumën 142.212 lekë¹⁰.
16. Komisioni, pasi përllogariti shpenzimet jetike për periudhën në fjalë, në vlerën 143.405 lekë¹¹, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj mund të dispononin kursime dhe të përballonin me të ardhurat e tyre, vetëm një pjesë të këtij investimi, në vlerën prej 61.459 lekësh. Sipas përllogaritjeve të kryera nga njësia e shërbimit ligjor, mbi mundësitë financiare për blerjen e truallit me sip. 200 m², ka rezultuar një mungesë disponibiliteti financiar në shumën prej – 438.541 lekësh, për këtë investim, për të cilën subjektit i ka kaluar barra e provës, njëkohësisht me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

17. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, lidhur me burimet financiare të përdorura për blerjen e kësaj pasurie ka pohuar se punësimet në Greqi gjatë periudhës 1992 – 1993 të bashkëshortit dhe në korrik 1994 -janar 1995 të saj, kanë qenë informale dhe nuk ka mundësi që t'i provojë. Subjekti ka shtuar se gjatë kohës që ka qenë e punësuar në Këshillin e Rrethit Sarandë, ka punuar paralelisht edhe si nd/gjyqtare joefektive në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, emëruar me vendim të KLD-së në prill të vitit 1995.
18. Për këtë, subjekti ka paraqitur në seancën dëgjimore një vërtetim¹² të lëshuar nga KLGj-ja, që provon se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, është emëruar me vendim të KLD-së nr. ***, datë 30.3.1995, si nd/gjyqtare joefektive në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe me vendimin nr. ***, datë 12.4.1995, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Kjo e fundit ka konfirmuar se dokumentacioni përpara vitit 1997 është djegur tërësisht në trazirat e vitit 1997.

Vlerësimi i trupit gjykues

¹⁰ Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 4.6.2020, rezulton se z. S. P. ka përfituar të ardhura nga pensioni për periudhën 15.9.1991 – 31.12.1996, në masën 92.128 lekë, ndërsa K. P. ka përfituar të ardhura nga pensioni për periudhën 1.10.1992 – 31.12.1996, në masën 79.611 lekë. Komisioni llogariti të ardhurat deri në shkurt të vitit 1996, kur është kryer investimi.

¹¹ Për këtë periudhë janë konsideruar shpenzimet jetike në masën 70 % të të ardhurave familjare.

¹² Vërtetim nr. *** prot., datë 7.7.2020, nga KLGj-ja.

19. Në vijim të analizës së provave të depozitura nga subjekti, Komisioni ka ripërlllogaritur mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie, duke marrë në konsideratë të ardhurat e provuara me dokumente ligjore të paraqitura nga subjekti, në përputhje me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe konkretisht:
- të ardhurat e prindërve të bashkëshortit nga pagat, për periudhën 1994 – shkurt 1996, rezultojnë në shumën 331.055 lekë. Pas zbritjes së shpenzimeve jetike, në masën 70 % të të ardhurave, rezultojnë një mundësi kursimi në shumën prej 99.316 lekësh;
 - të ardhurat e subjektit të rivlerësimit si ndihmës gjyqtare joefektive vërtetohen nga vërtetimi i ISSh-së, ku rezultoi se për muajt shkurt dhe mars të vitit 1996, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë kanë qenë në vlerën 14.000 lekë/muaj *bruto*. Në këto kushte, duke përllogaritur për periudhën në fjalë që subjekti ka punuar si gjyqtare joefektive (emëruar më 30.3.1995), rezultojnë të ardhura shtesë në masën 125.076 lekë edhe për periudhën prill 1995 – 15 shkurt 1996, për të cilën ndonëse mungon dokumentacioni provues mbi shumat respektive të përfituara, është e provuar marrëdhënia e punësimit. Pas zbritjes së shpenzimeve jetike, në masën prej 70 % të të ardhurave të përllogaritura, rezultojnë një mundësi kursimi shtesë në vlerën prej 37.523 lekësh.
20. Duke mbajtur në konsideratë edhe të ardhurat e sipërpërshkruara, së bashku me të ardhurat e përfituara nga subjekti, nëpërmjet punësimit në Këshillin e Rrethit Sarandë, si dhe të ardhurat e prindërve të subjektit, nga pensionet respektive, do të rezultojnë në total në masën 660.995 lekë, si dhe një mundësi kursimi në masën 198.299 lekë. Rrjedhimisht, në këto kushte, mungesa e burimeve të ligjshme, për blerjen e pasurisë truall, në analizë, ndryshe nga sa ishte konkluduar në rezultatet e hetimit administrativ, rezultojnë në shumën – 301.701 lekë, për të gjithë periudhën deri në vitin 2003, sikurse është pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 1

Përshkrimi	Vlera monetare ekuivalenti ne Leke
Blerje trualli në ***, Sarandë	- 500 000
Të ardhurat e subjektit deri në shkurt 96'	187 728
Të ardhurat e prindërve të bashkëshortit	331 055
Të ardhurat e prindërve të subjektit	142 212
Shpenzimet jetike	- 462 696
Rezultati	- 301 701

3. Apartament banimi me sip. 95.30 m², me vlerë 4.509.000 lekë, si dhe njësi shërbimi me sip. 50 m², e tjetërsuar në vitin 2016, në Gjirokastrë.

21. Këto pasuri janë deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2008. Më pas, në deklaratën *Vetting* është deklaruar vetëm pasuria e llojit apartament me sip. 95.30 m², ndodhur në

lagjen “***”, nr. pasurie ***, z. k. ***, Gjirokastrë, pasi njësia e shërbimit ishte shitur ndërkohë.

22. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për blerjen e pasurive në fjalë janë përdorur këto burime financiare:
- a. kursimet familjare të deklaruara më parë si gjendje *cash* në shumën 2.300.000 lekë¹³;
 - b. kursimet e realizuara gjatë vitit 2008 në shumën 1.100.000 lekë;
 - c. të ardhura nga dhënia në përdorim/me qira e ambientit (pa një vlerë të përcaktuar);
 - d. hua¹⁴ në shumën prej 30.000 euro¹⁵, marrë më 31.12.2008, nga motra e subjektit të rivlerësimit, znj. E. S. R.
23. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimet e krijimit për blerjen e apartamentit në fjalë nga kursimet familjare dhe nga huaja prej motrës së saj, znj. E. R.
24. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se pronësia mbi këtë apartament është fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.12.2008, të nënshkruar me shoqërinë ndërtuese “***” sh.p.k., me çmim shitjeje (95.30 m² x 30.000 lekë/m²)¹⁶, në vlerën totale prej 2.859.000 lekësh. Kjo shumë, sipas deklarimit të palëve në kontratën e shitblerjes ishte likuiduar tërësisht nga blerësit jashtë zyrës noteriale. Përveç çmimit të shitjes, subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar gjithashtu edhe pagesën e shumës prej 1.650.000 lekësh për kryerjen e punimeve shtesë në këtë pasuri.
25. Gjithashtu, ka rezultuar se në datën 10.12.2008, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kishin nënshkruar po me shoqërinë ndërtuese “***” sh.p.k.¹⁷, një tjetër kontratë shitblerjeje për një tjetër pasuri të paluajtshme, konkretisht, kontratën me nr. *** rep., nr. *** kol., me objekt shitblerjen e një njësie shërbimi me sip. 50 m² me çmim shitjeje 30.000 lekë/m², me vendndodhje edhe kjo në Gjirokastrë.
26. Vlera e kësaj njësie shërbimi, sipas kontratës së mësipërme, ka qenë në vlerën 1.500.000 lekë dhe përveç çmimit të shitjes, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe pagesën prej 900.000 lekësh, për kryerjen e punimeve shtesë.
27. Komisioni, e vlerësoi të nevojshëm kryerjen e një verifikimi krahasimor të çmimit të shitblerjes së pasurive të ngjashme me ato në analizë dhe, për këtë, iu drejtua zyrës së ASHK-së Gjirokastrë me shkresën nr. *** prot., datë 17.4.2020, duke i kërkuar që të vinte në dispozicion disa kontrata shitblerjeje me objekt pasuri të ngjashme me pasuritë e

¹³ Kursimet e deklaruara më parë, të cilat përkojnë me deklaratimet e subjektit në DIPP-në përkatëse.

¹⁴ Në deklaratën *Vetting*, deklaroi se huaja është shlyer tërësisht në vitet 2009 – 2013. Me vërtetimin e datës 20.10.2016 lëshuar nga “Alpha Bank” Albania Gjirokastrë, rezultoi se transferata ka ardhur në llogarinë e z. A. B. nga Greqia në datën 31.12.2008 dhe është tërhequr nga z. A. B. në datën 5.1.2009.

¹⁵ Në DIPP-në e vitit 2005 rezultoi se subjekti ka deklaruar se ka marrë hua në shumën prej 25.000 euro nga motra e saj, znj. E. R. me anë të transfertës bankare për blerjen e një apartamenti dhe blerja e tij nuk është realizuar dhe huaja është kthyer. Huaja është marrë në datën 1.2.2006 dhe është kthyer në datën 18.4.2006.

¹⁶ Bazuar në Udhëzimin nr.1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008, përcaktoi për koston mesatare të ndërtimit për vitin 2008 se: Çmimi për njësi (mesatare aritmetike) sipërfaqe shfrytëzimi është 33.876 lekë dhe sipërfaqe ndërtimi është 28.024 lekë për qytetin e Gjirokastrës. Ndërsa për të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve sipas qyteteve për vitin 2008, rezultoi se kostoja mesatare e shitjes lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi në tregun e lirë është 53.731 lekë.

¹⁷ Z. A. P. si administrator i shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k., ka deklaruar nëpërmjet deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2015, se subjekti i rivlerësimit ka blerë nga kjo shoqëri apartamentin e banimit dhe njësinë e shërbimit, si dhe janë kryer punime shtesë në apartament dhe njësinë e shërbimit, përkatësisht në vlerën 1.650.000 lekë dhe 900.000 lekë.

sipërcituara (apartament banimi dhe njësi shërbimi), si dhe të informonte lidhur me çmimin e shitblerjes së banesave dhe njësive të shërbimit për vitin 2008, si dhe për çmimin mesatar të shitblerjes së njësive të shërbimit për vitin 2016¹⁸.

28. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ASHK Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2020, ka bërë me dije se në vitin 2008 çmimi mesatar¹⁹ i shitjes në tregun e lirë për sipërfaqe shfrytëzimi të apartamenteve në Gjirokastër ka qenë në vlerën 53.731 lekë/m² dhe për sipërfaqe njësi shërbimi ka qenë 1.5 herë më i lartë se çmimi për m² i ndërtimit të apartamenteve, pra, $53.731 \text{ lekë} \times 1.5 = 80.596 \text{ lekë/m}^2$.
29. Në vitin 2008, subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin me çmimin 30.000 lekë/m², pra, në total $95.3 \text{ m}^2 \times 30.000 \text{ lekë/m}^2 = 2.859.000 \text{ lekë}$. Përveç këtij çmimi, subjekti i rivlerësimit ka përballuar edhe pagesën e shumës prej 1.650.000 lekësh për kryerjen e punimeve shtesë. Pra, në total, kostoja totale për këtë apartament, sipas deklarimeve të subjektit ka qenë $2.859.000 + 1.650.000 = 4.509.000 \text{ lekë}$.
30. Po ashtu, në vitin 2008, siç u përmend edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit ka blerë *njësine e shërbimit* me çmimin prej 30.000 lekësh/m², pra, në total $50 \text{ m}^2 \times 30.000 \text{ lekë/m}^2 = 1.500.000 \text{ lekë}$. Edhe për këtë pasuri, veç vlerës së këtij çmimi, subjekti ka kryer pagesën e shumës prej 900.000 lekësh, për punime shtesë. Pra, në total, kostoja finale e kësaj pasurie ka arritur vlerën $1.500.000 + 900.000 = 2.400.000 \text{ lekë}$.
31. Duke u bazuar në çmimin mesatar të komunikuar nga ASHK-ja Gjirokastër, çmimi mesatar i tregut për këto pasuri do të kishte qenë, si vijon:
 - a. për blerjen e apartamentit me sip. $95.30 \text{ m}^2 \times 53.731 \text{ lekë/m}^2 = 5.120.563 \text{ lekë}$, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paguar në total, së bashku me punimet shtesë, vlerën prej 4.509.000 lekësh;
 - b. për blerjen e njësisë së shërbimit me sip. $50 \text{ m}^2 \times 80.596 \text{ lekë/m}^2 = 4.029.800 \text{ lekë}$, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paguar në total, së bashku me punimet shtesë, vlerën prej 2.400.000 lekësh.
32. Gjithashtu, ASHK Gjirokastër ka përcjellë në Komision vetëm një kontratë shitblerjeje, konkretisht, kontratën nr. *** rep., nr. ***kol., datë 24.12.2008, me palë shitëse, pikërisht shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., dhe palë blerëse M. S. me objekt njësi shërbimi në katin përdhes, me sip. $49.20 \text{ m}^2 \times 30.000 \text{ lekë/m}^2$, me vlerë totale 1.476.000 lekë. Sipas kontratës së shitblerjes, të vënë në dispozicion nga ASHK-ja Gjirokastër, duket se edhe në këtë rast çmimi i shitjes për m², nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., ka qenë 1.7 herë më i ulët se çmimi mesatar i tregut.
33. Në këto kushte, Komisioni i rikërkoi institucionit ASHK Gjirokastër, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 14.5.2020, disa (së paku tre) kontrata të tjera të ngjashme me ato në shqyrtim, praktikën e regjistrimit të pasurive në fjalë, si dhe dokumentacionin lidhur me rivlerësimin e tyre dhe me pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse. Nga dokumentacioni i administruar në vijim, ka rezultuar se shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. ka shitur shumë apartamente dhe njësi shërbimi të tjera, në të njëjtin objekt, me të njëjtin çmim – pra, pa

¹⁸ Njësia e shërbimit është shitur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2016.

¹⁹ Mbështetur në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008.

bërë dallimin midis tipologjisë si apartament banimi apo si njësi shërbimi dhe të gjitha këto çmime kanë rezultuar të ngjashme me ato që ka blerë edhe subjekti i rivlerësimit.

34. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 6 kontrata shitblerjeje të pasurive të paluajtshme të llojit apartament dhe njësi, të lidhura mes shoqërisë “****” sh.p.k. me blerës të ndryshëm, në të cilat çmimi për m² ka qenë, gjithashtu, 30.000 lekë, si dhe një deklaratë noteriale të ish-administratorit të kësaj shoqërie. Më konkretisht, janë paraqitur:
- a. kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2009, mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasve N. M., K. M., shitur njësi me sip. 36.90 m², me vlerë 1.107.000 lekë (30.000 lekë/m²);
 - b. kontrata nr. ***rep., nr. *** kol., datë 10.12.2008, mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit G. B., shitur njësi me sip. 24.80 m², me vlerë 744.000 lekë (30.000 lekë/m²);
 - c. kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.12.2008, mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit E. H., shitur njësi me sip. 35.50 m², me vlerë 1.605.000 lekë (30.000 lekë/m²);
 - d. kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.12.2008, mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasve A. K. dhe M. K., shitur apartament me sip. 95.30 m², me vlerë 2.859.000 lekë (30.000 lekë/m²);
 - e. kontrata nr. ***rep., nr. *** kol., datë 3.12.2008, mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasve O. B. dhe I. B., shitur apartament me sip. 90.50 m², me vlerë 2.715.000 lekë (30.000 lekë/m²);
 - f. kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.12.2008, mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetas V. K., shitur apartament me sip. 52.20 m², me vlerë 1.566.000 lekë (30.000 lekë/m²);
 - g. deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.7.2020, të lëshuar nga ish-administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., z. A.P., në të cilën ka deklaruar se: “[...] Në janar 2008 kam lidhur marrëveshje për shitjen e dy pasurive të llojit apartament dhe njësi shërbimi (zyrë) me shtetasin A. B., me çmimin e përcaktuar në kontratat përkatëse. Me këtë çmim janë shitur edhe ambientet e tjera me të njëjtin destinacion [...]”.
35. Në këto kushte, Komisioni konkludon se nga një vlerësim tërësor i dinamikës së marrëdhënieve juridiko-civile në analizë, duke iu referuar përmbajtjes së të gjithë dokumentacionit të administruar, gjendja faktike që ka rezultuar në fazën konkluzive të këtij procesi, e përjashton mundësinë e ekzistencës së ndonjë trajtimi preferencial,²⁰ për sa kohë është provuar se edhe shitjet e tjera, të apartamenteve apo të njësive të shërbimit, pjesë përbërëse të të njëjtit pallat, janë kryer me të njëjtin çmim.
36. Gjithashtu, lidhur me diferencën midis çmimit të blerjes dhe të shitjes së njësisë së shërbimit, Komisioni iu drejtua subjektit me pyetësorin nr. 3, i cili ka sqaruar se nuk ka kryer punime apo riparime shtesë, përveç atyre të deklaruara në vitin 2008 dhe se rritja e vlerës në treg të kësaj pasurie, pas një periudhe 8-vjeçare nga blerja, ka ardhur si pasojë e

²⁰ Gjykata e Apelit Gjirokastër me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2019, ka informuar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështjen me nr. *** vendimi, datë 12.4.2006, ku palë ka qenë shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., por rezulton se marrëdhënia juridiko-civile midis palëve ka lindur 2 vite më pas.

pozicionimit të saj në qendër të qytetit. Subjekti shpjegoi gjithashtu se përpara shitjes është kryer edhe rivlerësimi²¹ i pasurisë nga eksperti i licencuar dhe se shitja është bërë në respektim rigoroz të procedurave ligjore, duke u paguar edhe tatimet përkatëse. Këto shpjegime janë konsideruar bindëse nga Komisioni dhe të bazuara në dokumentacionin ligjor të rivlerësimit të pasurisë në fjalë.

37. Komisioni, për sa i përket deklarimeve, veç të tjerash, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar rregullisht në rubrikën përkatëse të detyrimeve financiare, duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2009 deri në atë të vitit 2013 dhe në deklaratën *Vetting*, shlyerjen e huas, të përdorur për këto pasuri, në shumën prej 8.100 euro çdo vit, nga të cilat shuma prej 6.000 euro ishte *principal* dhe shuma prej 2.100 euro përbënte interesin e huas.
38. Përgjatë hetimit administrativ, veç dokumenteve të sipërpërmendura, është administruar dokumentacioni, si vijon:
 - a. ZVRPP-ja Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 18.6.2018, ka konfirmuar pasurinë e llojit apartament me nr. ***, nr. *** regjistri hipotekor, në z. k. ***, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit;
 - b. vërtetim hipotekor²² lëshuar më 18.10.2016, për pasurinë me nr. ***, në z. k. ***, me sip. 95.3 m², në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit;
 - c. kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.12.2008, lidhur ndërmjet palës shitëse shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. dhe palës blerëse A. dhe Irena Brahimi, për blerjen e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament me sipërfaqe 95.30 m², me vlerë 2.859.000 lekë, likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale;
 - d. deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2015, lëshuar nga z. A. P., në cilësinë e administratorit të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., për vitin 2008, në të cilën ka deklaruar se shtetasit A. B. dhe Irena Brahimi kanë blerë në atë vit nga kjo shoqëri apartament banimi me sip. 95.30 m² dhe njësi shërbimi me sip. 50 m². Nga z. A. B. janë kryer punime shtesë në apartament në vlerën 1.650.000 lekë dhe në njësinë e shërbimit në vlerën 900.000 lekë;
 - e. kontratë huaje e datës 31.12.2008, jo në praninë e noterit, midis znj. E. R. dhe subjektit të rivlerësimit, për dhënien e huas në shumën 30.000 euro, nëpërmjet transfertës bankare (të datës 31.12.2008), në “Alpha Bank”, me interes 7 % në vit dhe afat 5-vjeçar.

3.1 Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni mori në shqyrtim burimet financiare që, sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*, janë përdorur për blerjen e saj.

a. Kursimet familjare në shumën 2.300.000 lekë

²¹ Në vërtetimin hipotekor është përshkruar te seksioni i komenteve nga regjistruesi: R.V.P. me vlerë 6.000.000 lekë.

²² Në vërtetimin hipotekor është përshkruar te seksioni i komenteve nga regjistruesi: R.V.P. me vlerë 8.500.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 8, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2020, të lëshuar nga z. D. Z., i cili ka deklaruar se ka kryer në vitin 2016 rivlerësimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit, apartament dhe njësi shërbimi, kundrejt tarifës totale prej 30.000 lekësh.

39. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni rezulton se gjatë vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka realizuar të ardhura nga punësimi në shumën 1.286.636 lekë²³, ndërsa bashkëshorti ka realizuar të ardhura nga punësimi në shumën totale 647.414 lekë²⁴.
40. Po ashtu, gjatë vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në shumën 760.000 lekë, nga shitja e automjetit të vjetër me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2007, nga përmbajtja e së cilës ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shitur automjetin tip “Mercedes Benz” me targa ***, në vlerën 760.000 lekë²⁵.
41. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* të disponuara në banesë në DIPP-në përkatëse në vitin 2005, shumën prej 450.000 lekësh, në vitin 2006 shumën prej 1.450.000 lekësh dhe në vitin 2007, në total, disponimin e shumës *cash* 2.300.000 lekë.
42. Komisioni, nëpërmjet rezultateve të hetimit, ka njoftuar subjektin se nga analiza financiare e kryer nga njësia e shërbimit ligjor, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme, në masën – 237.127 lekë, përgjatë vitit 2007, për të përballuar investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara si gjendje *cash* në vlerën 2.300.000 lekë.

b. Kursimet e realizuara përgjatë vitit 2008 në shumën prej 1.100.000 lekë

43. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin ka realizuar të ardhura në masën 2.143.864 lekë²⁶ dhe nga analiza financiare ka rezultuar se për të kryer të gjitha investimet, shpenzimet dhe kursimet e pretenduara në shumën 1.100.000 lekë gjatë atij viti, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme në masën - 288.987 lekë.

b.1 Lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë së shërbimit

44. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2008, ka deklaruar shumën prej 295.000 lekësh, si të ardhura nga dhënia me qira e njësisë së shërbimit²⁷, për periudhën prill-shtator 2008.
45. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se më 23.5.2014, z. A. B. ka paguar në BKT detyrimet tatimore²⁸ mbi të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e njësisë së shërbimit përgjatë viteve 2008 – 2009, me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k.
46. Lidhur me këtë marrëdhënie, me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2015, znj. O. I., në cilësinë e ish-administratores së shoqërisë “****” sh.p.k., ka

²³ Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 19.1.2017, lëshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, ku subjekti i rivlerësimit, gjatë vitit 2007, ka përfituar shumën prej 1.228.496 lekë nga paga dhe 58.140 lekë të ardhura nga fondi i veçantë.

²⁴ Bazuar në vërtetimin datë 13.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Shëndetësore Gjirokastrë, në të cilin është vërtetuar se z. A. B. si mjek familjeje ka përfituar të ardhura gjatë vitit 2007, në shumën 287.414 lekë. Gjithashtu, me vërtetimin e laboratorit “****”, datë 13.10.2016, është konfirmuar punësimi si mjek mikrobiolog në vitin 2007, me të ardhura në shumën 360.000 lekë.

²⁵ Lidhur me të ardhurat me burim të ligjshëm të realizuara nga kjo shitje, referojuni analizës së pasurisë me nr. 4.

²⁶ Të ardhurat nga dhënia me qira të ambientit të shërbimit, në masën 295.000 lekë për periudhën prill - shtator 2008 dhe shumën 150.000 lekë për periudhën tetor – dhjetor 2008 (deklaruar në DIPP-në e vitit 2009), nuk janë konsideruar në analizën financiare për sa kohë rezulton të jetë dhënë në përdorim/qira përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.

²⁷ Kjo njësi shërbimi rezulton të jetë ndarë në dy njësi/ambiente me sipërfaqe nga 25 m² secila.

²⁸ Për periudhën prill 2008- mars 2009, rezulton se është paguar në BKT sipas mandatit datë 23.5.2014, shuma 60.000 lekë me përshkrim tatim qiraje për zyrat marrë me qira nga shoqëria “****”. Në total shuma e paguar është 194.000 lekë, përfshirë këtu tatimet nga qiraja për vitet 2008-2009, 2011, 2012 dhe 2013.

deklaruar se në periudhën prill 2008 - mars 2009, kjo shoqëri ka marrë në përdorim ambientin zyrtar me sip. 50 m² nga z. A.B., kundrejt pagesës së shumës 50.000 lekë/muaj.

47. Komisioni, bazuar në sa më lart, ka konkluduar se mungonte legjitimiteti për të përfituar të gjitha këto shuma monetare, pasi këto të ardhura pretendohen si të krijuara edhe gjatë periudhës prill-dhjetor 2008 – nga qiradhënia e një sendi për një periudhë që ende nuk ishte fituar titulli i pronësisë dhe as nuk ishte lidhur ndonjë kontratë porosie dhe, për rrjedhojë, as nuk mund disponoheshin të drejtat reale mbi këtë pasuri, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe aq më pak të mund të transferoheshin për t'u gëzuar nga persona të tretë, me kundërshtim. Gjithashtu, marrëdhënia civile e qiradhënies nuk është e provuar as me kontratë, as me dokumentacion ligjor lidhur me pagesat e kryera nga shoqëria “***” sh.p.k., veç deklaratës noteriale të sipërcituar.
48. Komisioni, pasi ka analizuar dokumentacionin dhe pretendimet e paraqitura, nuk i çmon bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me këtë pikë, sipas të cilave marrëdhënia juridike kishte ekzistuar *de facto* dhe kishte gjeneruar të ardhura të ligjshme. Për rrjedhojë nuk janë marrë në konsideratë, në analizën financiare, shumat e pretenduara si të përfituara përgjatë periudhës prill-dhjetor 2008, nga qiradhënia e pasurisë së sipërcituar.

c. Lidhur me huan e marrë, në shumën prej 30.000 euro, nga motra e subjektit të rivlerësimit, znj. E. R.

49. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, marrjen e huas në vlerën 30.000 euro nga motra e saj, znj. E. R.. Me vërtetimin e datës 20.10.2016, “Alpha Bank” sh.a., ka bërë me dije se më 31.12.2008, në llogarinë nr. ***, në euro, në emër të z. A. B. ka ardhur shuma prej 30.000 euro nga Greqia, e dërguar nga znj. E. R., shumë e cila është tërhequr prej tij, më 5.1.2009.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

50. Lidhur me dokumentacionin provues të shlyerjes së çmimit total të shitblerjes së apartamentit, subjekti i rivlerësimit është pyetur në pyetësonin nr. 5, datë 8.1.2020, ku ka shpjeguar se këto veprime janë kryer përpara 11-12 vjetësh në arkën e shoqërisë ndërtuese dhe se nuk i disponon. Gjithashtu, subjekti bëri me dije se është interesuar edhe te shoqëria ndërtuese, ku ka marrë informacionin se kjo e fundit ka mbyllur aktivitetin dhe ka kaluar me status *pasiv* që prej vitit 2012 dhe, për rrjedhojë, gjendet në pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacionin e kërkuar. Megjithatë, për të ndihmuar procesin, subjekti detajoi se në fillim të vitit 2008 ka paguar kapar në shumën 500.000 lekë për apartamentin, 500.000 lekë për njësinë e shërbimit dhe pjesa tjetër është paguar me huan e deklaruar.
51. Lidhur me përdorimin e kësaj shume është konstatuar një mospërputhje ndërmjet datave të nënshkrimit të kontratave (apartamentit dhe njësisë së shërbimit) dhe datës së transferimit të huas (transferuar më 31.12.2008 nga huadhënësja). Subjekti i rivlerësimit, është pyetur edhe mbi këtë mospërputhje, i cili në përgjigje të pyetësonit nr. 6, datë 21.1.2020, pohoi se datat që mbajnë kontratat janë datat e përpilimit të aktit nga noterja dhe jo datat e nënshkrimit, pasi procesi i nënshkrimit është finalizuar në javën e parë të vitit 2009, kohë kur është tërhequr huaja. Mospërputhja ka ardhur si pasojë e fillimit të krizës greke dhe vështirësive nga bankat në atë vend, lidhur me politikën e transferimit të fondeve jashtë

Greqisë dhe, së dyti, pasi administratorët e shoqërisë e kishin të pamundur firmosjen për shkak angazhimeve të tyre, fakt ky i deklaruar nga subjekti edhe në DIPP-në e vitit 2008, në f. 5: “*Sqaroj këtu se kontratat noteriale për blerjen e pasurisë janë nënshkruar në janar të vitit 2009, pasi duhet të paraqiteshin të tre ortakët e shoqërisë ndërtuese*”. Subjekti ka shtuar gjithashtu se nënshkrimi i njërit prej ortakëve të shoqërisë z. F. H., ka si karakteristikë citimin e dy numrave të fundit të vitit dhe në njërin nga kontratat ka nënshkruar me shifrat “09”.

Vlerësimi i trupit gjykues

52. Komisioni, për sa u përket shpjegimeve të dhëna nga subjekti, vlerëson se nisur nga fakti i provuar që shuma e dhënë hua, realisht i është nisur me transfertë bankare bashkëshortit të saj, më 31.12.2008, i cili e ka tërhequr në datën 5.1.2009 dhe, më pas, e ka kaluar në favor të shoqërisë ndërtuese, përpos mospërputhjeve të të dhënave të kontratës në fjalë, lidhur me momentin e kryerjes së pagesave, përdorimi i shumës së marrë hua për pagesën e kësaj pasurie mund të konsiderohet i besueshëm, për sa kohë provat e tjera direkte dhe indirekte të çojnë në këtë konkluzion. Në çmuarjen e kësaj çështje objekt vlerësimi trupi gjykues, pavarësisht se nga njëra anë konstaton se ka një mosperputhje të datave në harkun e shkurtër kohor, prej disa ditëve, ka vlerësuar dokumentet e administruara në raport me logjikën analitike të dinamikës së fakteve të provuara. Konkretisht rezulton e provuar se: (i) huaja është transferuar me transfertë bankare nga shteti grek, në favor të bashkëshortit të subjektit; (ii) kjo hua është paguar më pas në favor të shoqërisë ndërtuese, njëkohësisht palë shitëse e pasurisë në analizë (ndonëse *de facto* në një moment të mëpasëm nga ai i përshkruar në kontratën përkatëse); (iii) marrja e kësaj huaje është deklaruar rregullisht në DIPP-në e vitit përkatës, 2008, si dhe destinacioni i saj (duke specifikuar edhe detajet e përmbajtjes së marrëveshjes: shumën e marrë hua, mënyrën dhe afatet e kthimit pas të saj dhe interesin e parashikuar); (iv) subjekti ka deklaruar rregullisht dhe me saktësi në të gjitha DIPP-të e viteve 2009 – 2013: detyrimin e mbartur në sajë të kësaj huamarrjeje, pagesat e kryera për çdo vit në favor të huadhënësve - madje duke specifikuar shumat konkrete që i referoheshin kthimit pas të kapitalit, si dhe ato që përkonin me interesat e parashikuara, deri në shlyerjen totale të këtij detyrimi (në vitin 2013).
53. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se nga analizimi i deklarimeve periodike dhe vetting, si dhe të shpjegimeve të subjektit dhe të provave të administruara, në tërësinë e kësaj çështje, aspekti formal, - lidhur me termat kohorë, të pasqyruar jo saktësisht në përmbajtjen e një kontrate që rregullon një tjetër marrëveshje dhe që ka objekt dhe palë të ndryshme (veç subjektit) - konsiderohet në nivelin e një pasaktësie, duke konkluduar për deklarime të mjaftueshme të subjektit lidhur me këtë huamarrje dhe për rrjedhojë ka vlerësuar më tej plotësimin e kriterëve ligjore të një burimi të ligjshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutes dhe të nenit 32, të ligjit nr.84/2016, për sa arsyetohet në vijim.

c.1. Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 30.000 euro nga pala huadhënëse

54. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime dhe dokumentacion justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të motrës së saj, znj. E. R., të cilat kanë mundësuar dhënien e huas në shumën 30.000 euro. Në përgjigje të pyetësorit nr. 6, subjekti

ka sqaruar se motra dhe bashkëshorti i saj (z. I. R.), jetojnë prej shumë vitesh në Greqi dhe për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre, kanë paraqitur deklaratat tatimore të depozituara prej tyre, pranë autoriteteve greke lidhur me të ardhurat vjetore për periudhën 2002 – 2007, të cilat kanë rezultuar në shumën 121.414 euro.

55. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion²⁹ nga subjekti i rivlerësimit për huadhënësit, ka rezultuar se për periudhën 2005³⁰ –2008³¹, të ardhurat totale *neto* kanë qenë në vlerën 84.674 euro dhe duke zbritur edhe shpenzimet jetike³², si në tabelën më poshtë, ka rezultuar se kanë pasur mundësi financiare për të kursyer shumë më tepër se vlera e dhënë hua dhe, për rrjedhojë, Komisioni arriti në konkluzionin se huadhënësit e justifikojnë me burime të ligjshme huan e dhënë në vitin 2008, në masën 30.000 euro.

Tabela nr. 2

Te ardhurat nga Greqia 2005-2008	84 674
Shpenzimet jetike ne Greqi 2005-2008	- 27 084
Rezultati	57 590

56. Në konkluzion të vlerësimit të kësaj pasurie, duke marrë në konsideratë të gjitha të dhënat dhe vlerësimet e përshkruara në pikat e mësipërme, Komisioni ka përlloritur mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për të gjitha pagesat e kryera për blerjen e pasurive apartament dhe njësi shërbimi, gjatë vitit 2008, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në vlerën prej - 288.987 lekësh, siç është përshkruar edhe në tabelën në vijim.

Tabela nr. 3

Viti 2008	Vlera monetare ekuivalenti ne Leke
Blere apartament dhe njesi sherbimi se bashku me punimet shtese	- 6 909 000
Gjendje cash ne fund te vitit 2007	2 300 000
Ndryshimi ne mjetet monetare ne banke	151 175
Shpenzimet e vitit 2008	- 1 670 501
Te ardhurat e vitit 2008	2 143 864
Hua nga motra e subjektit	3 695 475
Rezultati	- 288 987

²⁹ Deklaratat pranë organeve tatimore greke, të vulosura me vulë apostile dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

³⁰ Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se huadhënësit E. dhe I. R. kanë blerë apartament në Athinë në datën 14.10.2004 dhe të ardhurat e tyre, deri në këtë moment, janë konsideruar nga Komisioni, si të ezauruara për investimin e kryer prej tyre.

³¹ Duke konsideruar edhe shumat e të ardhurave që kanë rezultuar nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në një moment të dytë, pasi fillimisht ishte konsideruar nga subjekti viti i deklarimit me vitin për të cilin përkonte e ardhura e deklaruar.

³² Shpenzimet jetike janë konsideruar në masën 564.25 euro/muaj, përlloritur kjo si një mesatare e shpenzimeve minimale jetike në studimet e kryera nga *Hellenic Statistical Authority* www.statistics.gr në Household Budget Survey 2004/2005 dhe Household Budget Survey 2008.

4. Automjet tip “Mercedes-Benz” Daimler Chrysler C 220 CDI, me targa *, viti i prodhimit 2000, me vlerë 5.500 euro.**

57. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2007, si dhe më pas në deklaratën *Vetting*. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit në fjalë kundrejt çmimit prej 5.550 euro dhe pagesën e detyrimeve doganore në shumën prej 300.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit.
58. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit në fjalë në vlerën 5.500 euro, pagesën e shumës prej 300.000 lekësh për detyrimet doganore dhe targimin, me burim krijimi nga shitja e automjetit së disponuar më parë dhe kursimet familjare.
59. Lidhur me rivlerësimin e kësaj pasurie, përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:
- kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2004, të lidhur ndërmjet palës shitëse I. Ç. dhe palës blerëse A. B., për blerjen nga ky i fundit të automjetit tip “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1992 dhe nr. shasie ***, kundrejt çmimit 250.000 lekë;
 - kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2007, e lidhur ndërmjet bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasit F. C., në cilësinë e palës blerëse, për shitjen e automjetit tip “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1992 dhe me nr. shasie ***, kundrejt çmimit 760.000 lekë;
 - deklaratë doganore e lëshuar nga autoritetet gjermane nr. ***, datë 9.7.2007, nga ku rezulton se shitësi i automjetit “Daimler Chrysler C220 CDI”, vit prodhimi 2000, ka qenë z. J. S., i cili së bashku me z. A. B. dhe z. G. M., kanë kryer deklarimin e vlerës së automjetit në shumën prej 5.500 euro;
 - deklaratë zhdoganimi e datës 18.7.2007, në të cilën z. A. B., ka kryer pagesën e detyrimeve doganore lidhur me këtë automjet, në shumën prej 261.825 lekë.
 - certifikatë pronësie datë 31.10.2007 e automjetit tip “Daimler Chrysler C220 CDI”, me nr. shasie ***, me targa ***, vit prodhimi 2000, i regjistruar në emër të bashkëshortit A. B.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

60. Për sa i përket burimit të të ardhurave të përdorura për blerjen e këtij automjeti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat në masën 760.000 lekë, të krijuara nga shitja e automjetit të disponuar më parë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2007, të lidhur ndërmjet bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e palës shitëse, dhe shtetasit F. C., në cilësinë e palës blerëse.
61. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se ky automjet i tipit “Mercedes Benz”, me nr. shasie ***, vit prodhimi 1992, është blerë më parë në vitin 2004 nga bashkëshorti i

subjektit të rivlerësimit, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2004, nga shtetasi I.Ç.³³, kundrejt çmimit 250.000 lekë.

62. Gjithashtu është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP të vitit 2004 se bashkëshorti ka kryer blerjen e automjetit në fjalë kundrejt çmimit 650.000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

63. Lidhur me diferencën ndërmjet çmimit të blerjes prej 250.000 lekësh në kontratën e shitblerjes dhe çmimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2004 prej 650.000 lekësh, pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka sqaruar se kjo shumë e deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 ka qenë shuma totale e pagesave për krijimin e pasurisë në fjalë, që përbëhet nga çmimi i blerjes së automjetit në shumën 250.000 lekë, vlera prej 171.474 lekësh për zhdoganimin, shpenzimet administrative, si dhe një shumë prej 100.000 lekësh për një shërbim tërësor të kryer nga bashkëshorti.
64. Komisioni, gjithashtu, i kërkoi sqarime subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, datë 28.10.2019, edhe për sa i përket shitjes së këtij automjeti në vitin 2007, me një çmim më të lartë, krahasuar me çmimin e blerjes në vitin 2004. Në përgjigje të këtij pyetësi subjekti ka shpjeguar se automjeti ishte në gjendje shumë të mirë dhe i është shitur një taksisti për shkak se ngjyra i përshtatej kushteve të tij, duke pranuar çmimin e vënë.
65. Lidhur me fitimin e realizuar nga kjo shitje, për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimin tatimor përkatës, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ka qenë detyrimi i subjektit të rivlerësimit të paguante tatimin mbi të ardhurat e përfituara. Pika 1, e nenit 7, të ligjit parashikon se individët (rezidentë) i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu, pasi konsiderohet se nga shitja e kësaj pasurie ka pasur fitime, atëherë individi përfitues i kësaj të ardhure duhet t’i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, detyrim i cili i atribuohet shitësit.
66. Për sa më sipër, nëpërmjet përllogaritjeve të kryera përgjatë dhe në konkluzion të hetimit administrativ, fitimi i realizuar prej 338.526 lekësh si diferencë e çmimit të shitjes prej 760.000 lekësh dhe çmimit të blerjes (250.000 lekë + 171.474 lekë tarifa e zhdoganimit), në përputhje me parashikimet ligjore, nuk janë konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë nuk janë paguar detyrimet tatimore. Rrjedhimisht, në rezultatet e njoftuara subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar se subjekti kishte pasur një mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në vitin 2007, në masën - 338.526 lekë. Gjithashtu, duket jashtë logjikës ekonomike, fakti që një mjet të shitet me një çmim më të lartë nga sa është blerë, pasi përgjatë periudhës së përdorimit normalisht verifikohet një amortizim.
67. Pasi u njoh me këtë rezultat, subjekti paraqiti në Komision një mandatpagesë të tatimit mbi fitimin e realizuar nga shitja e automjetit, që është përdorur si burim për këtë pasuri. Nëse do të konsiderohej edhe kjo shumë si një e ardhur e ligjshme nuk do të rezultonte më asnjë

³³ Në këtë datë subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur në shqyrtim çështjen e pronësisë së tokave, ku si përfaqësues ka qenë shitësi i automjetit z. I. Ç. (njëkohësisht përfaqësuesi ligjor në çështjen e znj. Gj. Gj.), pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastër mban nr. *** dhe është i datës 4.3.2014.

mungesë financiare lidhur me krijimin e kësaj pasurie, për sa kohë rezultati i vitit 2007 do të ishte me një bilanc pozitiv me 101.399 lekë.

68. Lidhur me tatimin e paguar nga bashkëshorti i subjektit, në datën 3.7.2020, në shumën prej 33.853 lekësh (me përshkrimin: tatim për kalimin e së drejtës së pronësisë), Komisioni vlerëson se nuk mund të merret në konsideratë dhe nuk mund të legjitimohet, *post Vetting*, të ardhura për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore më herët. Për sa më lart konkludohet, duke pasur në vëmendje edhe qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ³⁴ sipas të cilit: “[...] pagesa e detyrimeve tatimore pas deklaratës *Vetting* në janar të vitit 2017 është i papranueshëm dhe nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia ligjore, pasi nuk mund të zhbëjë qasjen e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me ligjin ndër vite, që u karakterizua nga mospagimi i detyrimeve tatimore në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të shlyheshin [...]].”
69. Në këto kushte, në konkluzion, trupi gjykues çmon se lidhur me krijimin e kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit rezulton me një mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, në shumën prej - 338.526 lekësh. Lidhur me këtë balancë negative trupi gjykues do të shprehet në vlerësimin tërësor, për vendimarrjen përfundimtare mbi çështjen në fjalë.

5. Lidhur me llogarinë bankare në “Alpha Bank” në emër të z. A. B., në vlerën 40.018 euro

70. Burimi i krijimit të shumave të depozituara në këtë llogari, sipas deklaratës *Vetting*, rrjedh nga shitja e pasurisë njësi shërbimi, me sip. 50 m² me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.10.2016, në vlerën 40.000 euro³⁵. Gjithashtu, “Alpha Bank”, nëpërmjet vërtetimit nr. ***, datë 20.10.2016, ka konfirmuar se në datën 18.10.2016 nga llogaria e noterit G. B. është transferuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, z. A. B., shuma prej 40.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes, të nënshkruar përpara këtij të fundit.
71. Për sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se nuk kishte dyshime mbi burimin e ligjshëm të shumës së depozituar në këtë llogari bankare, për sa kohë rrjedh nga shitblerja e sipërpërmendur dhe lidhur me këtë burim janë paguar të gjitha detyrimet tatimore.

6. Lidhur me shpenzimet e udhëtimit, të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, ndër vite, rezulton se:

72. Referuar të dhënave të hyrje-daljeve në sistemin *TIMS* në territorin e Shqipërisë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur ndër vite, kanë rezultuar një numër i konsiderueshëm udhëtimesh jashtë kufirit shqiptar.
73. Lidhur me 137 udhëtimet me hyrje-daljet brenda ditës, të kryera në periudhën 2006 – 2016 nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. B., është paraqitur një vërtetim i lëshuar

³⁴ Vendimi nr. ***, f. ***, pika ***, i KPA-së.

³⁵ ASHK – Gjyrokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2020, informon se çmimi i shitjes për vitin 2016 për njësitë ka qenë në vlerën 71.790 lekë/m².

nga laboratori “***” në datën 13.12.2019, në të cilën shprehet se, në cilësinë e punëdhënësit, laboratori ka përballuar/*rimbursuar* të gjitha shpenzimet e udhëtimit të kryera nga z. A. B., vajtje dhe kthim brenda ditës, me destinacion në Janinë. Por nuk rezultojnë të jenë specifikuar datat e sakta të udhëtimeve dhe shumat monetare të shpenzimeve të mbuluara nga ky punëdhënës.

74. Duke parë oraret përkatëse të hyrje-daljeve, si dhe kohën e qëndrimit, duket se udhëtimet në fjalë përputhen me shpjegimin se ato kanë qenë me destinacion Janinë dhe, për këtë arsye, duke i konsideruar bindëse shpjegimet e subjektit, Komisioni nuk ka përlllogaritur shpenzime në ngarkim të familjes së subjektit për to.
75. Po ashtu, lidhur me 12 udhëtimet e kryera hyrje-daljet brenda ditës nga subjekti i rivlerësimit, ku konstatohet se dalja ka qenë nga pika kufitare Kakavijë dhe hyrja në pikën kufitare Kapshticë dhe anasjelltas, gjatë periudhës 2012 – 2015, pasi është pyetur nëpërmjet pyetësorit nr. 4, datë 18.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se destinacioni i këtyre udhëtimeve ka qenë Korça, ku shkonte për shkak të detyrës, pasi asokohe ishte e komanduar në Gjykatën e Apelit Korçë. Duke parë oraret përkatëse të hyrje-daljeve, kohën e qëndrimit, si dhe duke rezultuar i bazuar fakti i punësimit të saj në atë qytet, përgjatë periudhës së analizuar, edhe në këtë rast shpjegimet janë çmuar bindëse se udhëtimet në fjalë kanë qenë me destinacion Korçën, për shkak të detyrës dhe, për këtë arsye, Komisioni nuk i ka konsideruar si udhëtime turistike jashtë Shqipërisë, duke mos përlllogaritur as shpenzime shtesë për to.

ANALIZA FINANCIARE

76. Në vijim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike ndër vite, duke përlllogaritur në mënyrë të detajuar sipas viteve përkatëse dhe duke përpunuar të gjitha të dhënat e administruara mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet, për të vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë ose jo të burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
77. Në përfundim, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mangësi financiare në total në shumën prej – 526.113 lekësh përgjatë periudhës 2003 – 2016 dhe – 301.701 lekë për periudhën përpara vitit 2003.
78. Në përfundim, trupi gjykues pas analizimit të provave shtesë të paraqitura nga subjekti dhe vlerësimeve përkatëse të kryera në raport me ligjin e zbatueshëm, çmon se – duke e parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe në tërësinë e tij kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi – kjo mungesë financiare, si dhe pasaktësitë e konstatuara në deklaratime, në vetvete, nuk kanë një peshë të tillë që të mund të përbëjë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra, të znj. Irena Brahimi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84.2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

79. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komision një raport për subjektin e rivlerësimit, me nr. *** prot., datë 2.11.2017, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi.
80. DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2019, i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është integruar me informacione të tjera dhe është deklasifikuar pjesërisht në datën 11.9.2019, me vendimin nr. ***, të KDZH-së. DSIK-ja ka konfirmuar edhe me raportin e dytë përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë, sipas saj, disa informacione të klasifikuara, nga ku ngriheshin dyshime mbi veprimtari të kundërligjshme të shfaqura në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korruptiv i referoheshin një periudhe përpara asaj të rivlerësimit.
81. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues është njohur me të dhënat e klasifikuara dhe ka administruar dhe shqyrtuar disa materiale që lidheshin pikërisht me to, të cilat pjesërisht janë trajtuar edhe në kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.
82. Për sa më sipër, Komisioni – pas hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016 dhe bazuar në dokumentet e administruara, si dhe mbi dokumentet dhe informacionet e klasifikuara, të verifikuara nga trupi gjykues pranë organeve ligjzbatuese – në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, në tërësi, arrin në përfundimin se nuk janë gjetur fakte apo rrethana bindëse, të mjaftueshme për të konkluduar për ndonjë favorizim apo ndikim të paligjshëm nga subjekti, nëpërmjet funksionit të tij, apo mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme, me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar.
83. Komisioni, në këto kushte, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, *indiciet* dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, nuk u gjetën elemente të mjaftueshme që të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. Vlerësimi i aftësive profesionale nga KLGj-ja

84. KLGj-ja ka përcjellë në Komision me shkresën e datës 14.2.2019, raportin e përpiluar nga ky institucion, për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, konkretisht lidhur me: aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
85. Nga shqyrtimi i dosjeve të përzgjedhura nga subjekti, KLGj-ja, përveç të tjerash, ka konstatuar se:

- a. Nga subjekti i rivlerësimit, në disa raste, nuk janë përdorur parimet e përgjithshme të së drejtës dhe referenca në jurisprudencën e gjykatave më të larta.
 - b. Lidhur me disa dosje është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, ka mungesë të dokumentacionit që tregojnë caktimin e datës së seancës së parë gjyqësore.
 - c. Në dispozitivët e vendimeve vërehet se nuk citohet e drejta e rekursit dhe nuk ka përdorur parime të përgjithshme të së drejtës, si dhe referenca në jurisprudencën e gjykatave më të larta.
86. Lidhur me shqyrtimin dhe gjetjet e KLGj-së, nga vëzhgimi i pesë dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, përpos një vlerësimi të përgjithshëm pozitiv, ky institucion ka konkluduar se:
- a. Në disa dosje është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, ka pasur mungesë të dokumentacionit, që tregojnë caktimin e datës së seancës së parë gjyqësore.
 - b. Në dispozitivët e vendimeve vërehet se nuk përshkruhet e drejta e rekursit dhe nuk shkruhen shpenzimet gjyqësore, duke mos plotësuar kështu elementët e kërkuar nga nenet 310/2 dhe 472 të Kodit të Procedurës Civile.
 - c. Gjithashtu nuk përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe dhe në disa raste nuk dokumentohen në procesverbal, shkaqet e fillimit me vonesë të seancave gjyqësore.
87. Sipas të dhënave të regjistrit të ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Irena Brahimi janë paraqitur 7 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat 3 janë arkivuar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, 3 ankesa të tjera janë verifikuar dhe është konkluduar për arkivimin e tyre, ndërsa 1 ankesë i është regjistruar për vlerësim profesional.
88. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Irena Brahimi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.
89. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin profesional të kryer nga KLGj-ja, në mënyrë të përmbledhur ka qenë, si vijon: *“[...] Lidhur me vonesat e shqyrtimit të dosjeve, duhet mbajtur parasysh se data e seancës së parë gjyqësore sipas nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile, përpara ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, caktohej nga kryetari i gjykatës dhe jo nga gjyqtari relator. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve, në dosje, depozitohet rregullisht vendimi im si relatore, për caktimin e seancës së parë gjyqësore. Në lidhje me ndonjë mangësi tjetër, ato mund të kenë ardhur si rrjedhojë e ngarkesës së madhe në punë dhe praktikës që ndiqej në përgjithësi, por që aktualisht janë korrigjuar [...].”*

C/2. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

90. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGj-së, dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku, nga organet ligjzbatuese, si dhe duke analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.

Dosja nr. 1

91. Komisioni iu drejtua me shkresën nr. *** prot., datë 30.1.2020 Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për vënien në dispozicion të dosjes gjyqësore, si dhe vendimin e gjykatës që i përket shtetasit R. C. dhe F. K., me përfaqësues z. R. H.
92. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2019 (2020), ka përcjellë në Komision materialin e kërkuar. Nga vendimi nr. ***, datë 17.12.2013, rezulton se relatore ka qenë subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi. Kjo çështje, me kërkuar shtetasin R. C., ka si objekt: “kundërshtim i vendimit penal për pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. 110/1, të vitit 2012”.
93. Gjithashtu Rezulton se Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. ***, datë 17.12.2013, ka vendosur: *“Lënie në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 6.9.2013, të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë”*. Ky fakt, përjashton mundësinë e ndonjë favorizimi dhe, për rrjedhojë, nuk konfirmohen informacionet e dyshimet e përcjella nga organet ligjzbatuese, lidhur me këtë çështje.
94. Gjithashtu, trupi gjykues, ku ishte pjesë edhe subjekti, në këtë rast, me parashtrimin se gjykata nuk ka kompetencë për të urdhëruar Prokurorinë për paraqitjen e akuzës, pasi është kompetencë ekskluzive e kësaj të fundit, ka konkluduar se: *“[...] I dëmtuari R. C. mund t'i drejtohet me ankim prokurorit më të lartë për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, për shkak të cilësimit ligjor të gabuar të veprës penale. Gjykata nuk ka të drejtë të marrë në shqyrtim nëse cilësimi ligjor i veprës penale të kryer nga prokurori i çështjes është ose jo i drejtë, sikurse ka vepruar Gjykata e Shkallës së Parë [...]”*.
95. Ndërkohë që, Komisioni në një këndvështrim më të gjerë të aspektit profesional të subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se përballë një situatë tjetër të ngjashme (në vendimin nr. ***, datë 1.2.2018, në ngarkim të avokatit A. Z.), ishte shprehur në mënyrë të ndryshme dhe urdhëruese, duke konkluduar që: *“[...] Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, duhet të formulojë akuzë për veprat penale të ‘Mashtrimit’ dhe ‘Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve’ [...]”*. Lidhur me shkaqet e këtyre dy qëndrimeve të ndryshme, përballë një situatë faktiko-ligjore të ngjashme, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, që ka argumentuar si në vijim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

96. Në lidhje me qasjen/vlerësimin e subjektit në çështjen e lartpërmendur - të konkluduar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 17.12.2013, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër me palë kërkuar R. Ç. me objekt: *“Kundërshtimi i vendimit penal për pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. ***, të vitit 2012”*, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ndryshimet e evidentuara nuk përbëjnë zbatim apo interpretim të ndryshëm të së njëjtës dispozitë ligjore, por se gjendemi përballë dy zbatimeve korrekte të dispozitave të ndryshme (të modifikuara ndërkohë, nga çështja e parë në të dytën). Konkretisht, vendimi penal i vitit 2013 është marrë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në fuqi në vitin 2013, ndërkohë që vendimi nr. ***, datë 1.2.2018 në ngarkim të avokatit A. Z., është marrë bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.

Në rastin e parë, në interpretim korrekt të dispozitës ligjore, si dhe duke u nisur nga fakti që hetimet ishin të plota - sikurse është cituar edhe në vendimin përkatës dhe as vetë i dëmtuari nuk ka ngritur pretendime për hetime të paplota (si në ankimin drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe në ankimin drejtuar Gjykatës së Apelit Gjirokastër) - Gjykata e ka orientuar personin e dëmtuar, me shprehjen: “Për sa pretendon, i dëmtuari R. C. mund t’i drejtohet me ankim prokurorit më të lartë për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal për shkak të cilësimit të gabuar ligjor të veprës penale”. Ndërsa në rastin e dytë, ishte detyrë e gjykatës, për shkak të ndryshimit të dispozitës në fjalë, që t’i kërkonte Prokurorisë ushtrimin e ndjekjes penale, nëse/kur plotësoheshin kushtet ligjore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka depozituar vendimin penal nr. ***, datë 17.12.2013, si dhe vendimin penal nr. ***, datë 1.2.2018, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Vlerësimi i trupit gjykues

97. Nga shqyrtimi dhe analizimi i materialit të administruar lidhur me çështjen e sipërpërmendur, së pari arrihet në konkluzionin se nuk ka elementë që të konfirmojnë informacionet e klasifikuara, me të cilat është njohur trupi gjykues. Po ashtu, lidhur me rezultatin e arritur nga Komisioni, përgjatë hetimit administrativ dhe të bërë me dije subjektit, trupi gjykues ka analizuar shpjegimet e subjektit duke mbajtur në vëmendje përmbajtjen aktuale, germa “c”, e pikës 3, të nenit 329, të Kodit të Procedurës Penale, që në disponon si detyrë të gjykatës, pikërisht “*kthimin e akteve prokurorit, duke urdhëruar që të formulohë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes, kur çmon se [...]*.” Nisur nga fakti që kjo dispozitë është shtuar me modifikimet e vitit 2017, arrihet në konkluzionin se në rastin e mëparshëm, të vitit 2013, gjykata nuk e ka pasur këtë mundësi/detyrë dhe, për rrjedhojë, qëndrimi dhe vendimmarrja e subjektit, në të dyja situatat e sipërpërkruara, ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, në atë moment.
98. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në çështje me rrethana të ngjashme, por ka zbatuar në përputhje me faktet e konstatuara, dispozitat përkatëse, por të ndryshme në përmbajtje midis vitit 2013 dhe 2018, për shkak të ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Penale, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017. Për rrjedhojë, për sa kohë lidhur me sa më lart janë dhënë shpjegime bindëse nga subjekti, të cilat shterojnë dyshimet e ngritura nga Komisioni në rezultatet e hetimit, trupi gjykues konkludon se nuk kanë rezultuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket çështjeve të trajtuara.

Dosja nr. 2

99. Komisioni, nisur nga informacionet dhe *indiciet* e marra nga organet ligjzbatuese, i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2020, vënien në dispozicion të kopjes së vendimit që i përket çështjes me të pandehur, z. E. I.
100. Pasi Gjykata e Apelit Gjirokastër vuri në dispozicion vendimin nr. ***, datë 23.1.2019, me të cilin kishte vendosur “*lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 24.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*”, nga përmbajtja e këtij të fundit është konstatuar se subjekti

i rivlerësimit nuk ka qenë anëtare e trupit gjykues që ka shqyrtuar këtë rast, pasi trupa gjyqësore vendimmarrëse ka qenë e përbërë nga gjyqtarët: A. B., S. D. dhe DH. L.

101. Nga sa më lart, Komisioni nuk kishte më shkaqe dhe hapësira për një thellim të hetimit administrativ lidhur me këtë çështje, për sa kohë nuk ka një provë, rrethanë, fakt konkret që evidenton ndonjë përfshirje të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, në këtë çështje. Për rrjedhojë, edhe në këtë rast informacionet e klasifikuara dhe *indiciet* me të cilat ishte njohur trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar nuk u gjetën të bazuara.

DENONCIMET

102. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku 27 denoncime – nga të cilat 5 kanë rezultuar të përsëritura. Në vijim të denoncimeve dhe të informacioneve të tjera që Komisioni ka marrë nga organet ligjzbatuese, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi.
103. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku, ka konstatuar se në përmbajtjen e pjesës më të madhe të tyre nuk janë evidentuar *indicie* apo elementë konkretë që mund të çonin në ndonjë shkelje procedurale apo cenim të të drejtave të palëve, ndërsa lidhur me disa prej denoncimeve janë kryer hetime të thelluara, duke administruar dosje hetimore dhe/ose gjyqësore, vendime specifike, si dhe procesverbale të seancave gjyqësore, që ndërthureshin me referencat e denoncimeve në fjalë.
104. Komisioni, në rezultatet e hetimit të njoftuara subjektit të rivlerësimit, veç të tjerash, ka përfshirë edhe disa denoncime nga publiku, lidhur me të cilët, pas një hetimi të thelluar, ishin kristalizuar disa gjetje që i janë kaluar si barrë prove subjektit të rivlerësimit.

Lidhur me denoncimin nr. * prot., datë 28.2.2019, të paraqitur nga shtetasi K. M.**

105. Për verifikimin e vërtetësisë së përmbajtjes së denoncimit, si dhe për administrimin e materialeve që lidheshin me pretendimet e ngritura në të, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Gjirokastër me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2019, e cila vuri në dispozicion vendimet³⁶ nga verifikimi i të cilave rezultoi se:
106. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me trupë gjyqësore të përbërë nga gjyqtarët M. Q., I. Brahimi dhe T. S. ka dhënë vendimin nr. ***, datë 18.5.2010, me paditës Sh. M. dhe palë e paditur ZVRPP-në Sarandë me objekt padie “detyrimin e ZVRPP-së Sarandë, të regjistrojë pronën e kthyer me vendimin nr. ***, datë 14.7.1994, të KKK Pronave, Bashkia Sarandë”.

³⁶ Vendimi që i përket çështjes me nr. ***; vendimi nr. ***, datë 18.5.2010; vendimi nr. ***, datë 14.13.2016; vendimi nr. ***, datë 11.10.2018; vendimi nr. ***, datë 1.2.2018; vendimi nr. ***, datë 11.4.2017; vendimi nr. ***, datë 7.3.2017; vendimi nr. ***, datë 13.12.2018; kopje e kërkesëpadisë së Këshillit të Ministrave të vitit 2015, pa numër protokolli, pa datë, por e firmosur nga përfaqësuesi i Avokaturës së Shtetit.

107. Objekt shqyrtimi ka qenë vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. ***, datë 12.2.2010.
108. Pas analizimit të akteve, në tërësinë e tyre, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vlerësuar jo të drejtë konkluzionin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë për shkak se: (i) nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk janë zbatuar dispozitat e nenit 79/a, të Kodit të Procedurës Civile; (ii) nga shqyrtimi i akteve provuese konstatohet se ka pasur mospërputhje etj.
109. Duke vlerësuar në përfundim se vendimi i KKKP-së me nr. ***, datë 14.7.1994, ka njohur si ish - pronar të sipërfaqes prej 76 Ha shtetasin z. M. M. dhe jo z. N. M.
110. Për shkak të shkeljeve të konstatuara, kjo gjykatë me vendimin nr. ***, datë 18.5.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 12.10.2010, duke e kthyer çështjen në atë gjykatë me një trup tjetër gjykues.
111. Më tej, Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit ka ngritur padi duke u ndarë ATK-së Tiranë dhe trashëgimtarëve M. M., Sh. M., me objekt “detyrimin për njohjen pronar” – konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. ***, datë 14.7.1994, të KKKP-së etj.
112. Ndër të tjera, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka marrë në shqyrtim aktin vendim i KKKP-së, me objekt pikërisht (pa) vlefshmërinë e vendimit nr. ***, datë 14.7.1994, të KKKP-së Sarandë, vendim ky në vetvete i shoqëruar me disa procese gjyqësore dhe kallëzime penale, ndër vite.
113. Palët e interesuara të procesit në fjalë kanë shfaqur ankesa të shumta dhe kjo problematikë është marrë në shqyrtim nga Task-Forca, e cila ka lënë rekomandime si: (i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. ***, datë 14.7.1994, të KKKP-së Sarandë; (ii) depozitimin e kallëzimit penal për veprën “falsifikim të dokumenteve”; (iii) urdhërimin e ZRPP-së të vendosi kufizimin e veprimeve mbi pasurinë e paluajtshme.
114. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila ka shqyrtuar çështjen përsëri me vendimin nr. ***, datë 31.10.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së Këshillit të Ministrave.
115. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, ku si relatores ka qenë subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi.
116. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, pas shqyrtimit të çështjes në fjalë me vendimin nr. ***, datë 13.2.2018, vendosi prishjen e vendimit civil nr. ***, datë 31.1.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
117. Nga sa më sipër, trupa gjyqësore sikurse sipërcituar, vërehet se ishin shprehur një herë me vendimin nr. ***, datë 18.5.2010, ku kishin vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 12.10.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
118. Lidhur me sa më lart, Komisioni konkludoi në rezultatet paraprahe se dukej se subjekti i rivlerësimit kishte shqyrtuar këtë çështje në kushtet e konfliktit të interesit, duke mospërmbushur detyrimin ligjor për të paraqitur dorëheqjen për shkaqet dhe arsyet e shprehura më sipër dhe, për këtë, i kaloi barrën e provës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

119. Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Apelit Gjirokastër nr. ***, datë 18.5.2010 dhe vendimin nr. ***, datë 13.12.2018, subjekti ka shpjeguar se në çështjen me palë Këshilli i Ministrave - Sh. M., për të cilën ka dalë vendimi nr. ***, datë 13.12.2018, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, ka dhënë dorëheqjen bazuar në nenin 72/4, të Kodit të Procedurës Civile, duke arsyetuar në aktin për parashtrimin e dorëheqjes se kishte shprehur mendim për konfliktin objekt gjykimi me vendimin nr. ***, datë 18.5.2010, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Dorëheqja e saj nuk është miratuar me vendim nr. *** prot., të datës 12.4.2018, të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Gjithashtu, subjekti ka referuar se edhe njëra prej palëve ndërgjyqëse është kërkuar përjashtimi i trupit gjykues. Por kërkesa ishte rrëzuar sipas rregullave procedurale civile, nga një trup tjetër gjykues. Për rrjedhojë, subjekti ka pohuar se ka qenë e detyruar të vazhdojë me gjykimin e çështjes, në përfundim të të cilit ka vendosur në bazë të ligjit dhe provave. Për të provuar sa më lart, subjekti ka paraqitur aktin e dorëheqjes së datës 11.4.2018, vendimin datë 12.4.2018, të Kryetarit të Gjykatës për mosmiratimin e dorëheqjes së saj, si dhe kopje të procesverbalit të seancave gjyqësore, ku evidentohen qartë disponimet për dorëheqjen dhe rrëzimin e kërkesës së përjashtimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

120. Në këto kushte, duke mbajtur në vëmendje qëndrimin e subjektit të rivlerësimit si dhe dokumentacionin mbështetës që është paraqitur në Komision, ky i fundit i gjen bindëse dhe të bazuara në provat e depozituara prapësimet dhe shpjegimet e subjektit dhe kësisoj nuk konstatohet provueshmëria e ndonjë elementi, që mund të çojë në konkluzionin se në rastin në analizë ka pasur një shqyrtim dhe/ose vendimmarrje në prezencën e një konflikti të interesave apo përgjegjësi të subjektit për mosparaqitje të kërkesës për dorëheqje, për sa kohë ky detyrim ligjor rezulton të jetë përmbushur.

Lidhur me denoncimin nr. * prot., datë 21.11.2018, të shtetasës Z. M. etj.**

121. Shtetasja Z. M. ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë dhe shqyrtim të çështjes në kushtet e konfliktit të interesit. Sipas ankimeses, gjyqtarja ka lidhje familjare dhe të njëjtin mbiemër me paditësit, duke u ndikuar për dhënien e një vendimi të padrejtë, në kundërshtim me interesat e shtetasve denoncues. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trupit gjykues, që ka dhënë vendimin nr. ***, datë 27.10.2009, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
122. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni konstatoi se vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastër nr. ***, datë 27.10.2009, është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 13.6.2013 - duke e vlerësuar atë si të dhënë në përputhje të plotë me ligjin, pa konstatuar shkelje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

123. Lidhur me pretendimin e denoncueses se subjekti i rivlerësimit ka të njëjtin mbiemër me palën paditëse dhe, për rrjedhojë, kjo rrethanë ka ndikuar në vendimmarrjen e saj, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 7, datë 19.5.2020,

në përgjigje të të cilit, ka sqaruar se nuk ka asnjë lidhje familjare me palët ndërgjyqëse në vendimin civil nr. ***, datë 27.10.2009, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Subjekti ka bashkëlidhur certifikatën e trungut familjar të vitit 1974, të z. S. P. (babai), i cili është fëmijë i vetëm dhe certifikatën e trungut të z. K. P., i cili ka emigruar prej vitit 1936 në SHBA, si dhe certifikatën familjare të datës 27.5.2020, për regjistrimet nga viti 1950 – 1974 në regjistrin e fshatit Leshnicë + 1/2 e Poshtme.

Vlerësimi i trupit gjykues

124. Nga shqyrtimi i vendimit të vënë në dispozicion nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, si dhe i dokumentacionit të administruar nga Komisioni (lidhur me paraardhësit e palëve), por edhe nga përgjigjet e dhëna nga subjekti lidhur me këtë denoncim, nuk konstatohet që subjekti i rivlerësimit të ketë lidhje familjare me palët ndërgjyqëse, apo me palën paditëse edhe pse me të cilët ka të njëjtin mbiemër, të vajzërisë, “Papa”. Për rrjedhojë, nuk ka elementë për të evidentuar ndonjë konflikt të mundshëm interesi përgjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë apo shkelje procedurale ose etiko-profesionale të subjektit për sa i përket përmbajtjes së këtij denoncimi.

Lidhur me denoncimin nr. * prot., datë 11.7.2018, të paraqitur nga shtetasi A. Z., me profesion avokat**

125. Denoncuesi, fillimisht, ka përshkruar një marrëdhënie interesash financiare, për sa kohë ka pasur me qira një pjesë të njësisë së shërbimit dhe konkretisht sipërfaqen prej 25 m², në pronësi të subjektit Irena Brahimi, të cilën e ka përdorur si zyrë. Midis shtetasit A. Z. dhe A. B. janë nënshkruar disa kontrata qiraje për njësinë e shërbimit për periudhën 2011 – qershor 2016, periudhë kur ambienti është lënë i lirë nga denoncuesi, i cili, pikërisht në këtë kohë ka debatuar me qiradhënësin, z. A. B., për “taksën mbi ndërtesën”, që sipas denoncuesit është paguar nga ky i fundit nga data e lidhjes së kontratës së parë të qirasë së vitit 2011e në vijim.
126. Denoncuesi ka bashkëlidhur procedimin penal të ngritur në ngarkim të personit të tij në cilësinë e të dyshuarit akuzuar për kryerjen e veprave penale “fshehja e të ardhurave” dhe “mashttrim”. Pas ankimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, vendimi është gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, ku anëtare ka qenë edhe znj. Irena Brahimi, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar vendimin në kushtet e konfliktit të interesit.
127. Nga dokumentacioni i administruar për këtë çështje nga Komisioni, rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. ***, datë 12.1.2018, ka vendosur kthimin e akteve të prokurorit duke e urdhëruar formulimin e drejtë të akuzës dhe kërkesës për gjykimin e saj. Kundër vendimit ka bërë ankim Prokuroria në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila me vendimin nr. ***, datë 1.2.2018, ku anëtare ka qenë edhe znj. Irena Brahimi - ka vendosur - lënien në fuqi të vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.
128. Nga sa më lart ka rezultuar se vendimi nr. ***, datë 1.2.2018, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, është dhënë mbi një vit e tre muaj më vonë nga përfundimi i marrëdhënies

kontraktuale të qirasë midis tyre³⁷. Gjithashtu, referuar vërtetimit të Prokurorisë Gjjirokastër nr. *** prot., datë 18.9.2018, rezulton se kallëzimi penal për veprën penale “përndjekje”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, nga shtetasi A. Z. ndaj shtetasit A. B. është regjistruar me nr. 816 prot., datë 12.9.2018 – mbi shtatë muaj më pas dhënies së vendimit të sipërpërmendur (të datës 1.2.2018).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

129. Pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pikë, veç të tjerash ka shpjeguar se në rastin konkret nuk ka ekzistuar asnjë element apo rrethanë nga ato të parashikuara në nenet 15 - 17 të Kodit të Procedurës Penale. Në vlerësim të pikës a, të nenit 17, të Kodit të Procedurës Penale, pasi si subjekti ashtu edhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur marrëdhënie interesi/kredie me avokatin A. Z. në kohën e shqyrtimit të çështjes penale, pasi marrëdhëniet ekonomike që rridhnin nga kontratat e qirasë ishin ndërprerë/shuar në shkurt të vitit 2016, pra, rreth dy vjet më herët se gjykimi në fjalë. Në vlerësim të pikës (ë) të dispozitës, që kërkon praninë e shkaqeve të tjera të rëndësishme të njëanshmërisë, subjekti shprehet se nuk ka pasur asnjë shkak të kësaj natyre, pasi nuk ka ekzistuar asnjë situatë konfliktuale me avokatin A. Z. Gjithashtu, ka shprehur se nëse avokati do të ndodhej në një situatë të tillë, ai vetë do të kërkonte përjashtimin e saj nga shqyrtimi i çështjes penale në ngarkim të tij, gjë që nuk e ka bërë.
130. Në mbështetje të qëndrimit të saj, subjekti ka paraqitur vendimin gjyqësor të datës 13.7.2018, të Gjykatës së Apelit Gjjirokastër “Për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim gjyqtari”. Me këtë vendim është shqyrtuar kërkesa e avokatit A. Z. për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit në një çështje penale, pikërisht, me pretendimin se ka pasur konflikt me bashkëshortin e saj, për pagimin e taksës së ndërtesës.
131. Gjykata e Apelit Gjjirokastër e ka rrëzuar kërkesën, pasi e ka gjetur të paprovuar shkakun e përjashtimit. Në këtë rast, subjekti është shprehur se edhe pse nuk qëndron shkakun i pretenduar nga denoncuesi, ishte e gatshme të mos vijonte shqyrtimin në fjalë, duke paraqitur kërkesën me shkrim të datës 12.7.2018. Ky qëndrim është marrë në vlerësim nga gjykata si mendim i gjyqtarit për të cilin kërkohet përjashtimi, në kuptim të nenit 21/1 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi gjyqësor i referohet në përmbajtje dhe mbështet mendimin me shkrim dhënë nga subjekti, duke rrëzuar ndërkohë si të paprovuara pretendimet e avokatit A. Z.
132. Gjithashtu, subjekti shton se në gjithë këtë periudhë (pas përfundimit të marrëdhënies kontraktore), janë gjykuar disa çështje ku avokati A. Z. ka vepruar si përfaqësues dhe në asnjë rast nuk ka kërkuar përjashtimin e saj. Subjekti, pasi ngre një pyetje, (Përse atëherë për gati një vit e gjysmë unë isha e besueshme dhe jo në konflikt interesi dhe u bëra e tillë vetëm pas dhënies së vendimit penal në ngarkim të avokatit?), konkludon se nga sa më sipër, provohet se nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit (në shkurt të vitit 2018), kur ka gjykuar çështjen penale me të pandehur A. Z.
133. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar sa më sipër ka depozituar dokumentacionin: vendimin “Për kërkesën për përjashtim gjyqtari”, datë 13.7.2018; Aktet “parashtresë

³⁷ Njësia e shërbimit me sipërfaqe totale 50 m² është shitur në datën 13.10.2016, trajtuar në pikën 5.

informuese”, të datave 14.9.2018 dhe 20.9.2018; shkresën “kërkohet verifikimi i vendimmarrjes në një proces penal”, datë 21.9.2018; vendimin gjyqësor nr. ***, datë 1.2.2018, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; vendimin gjyqësor nr. ***, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; aktdorëheqjen datë 24.4.2019; aktin “vendim për shqyrtimin e dorëheqjes”, datë 25.4.2019; vërtetimin nr. *** prot., datë 6.7.2020, të kancelares së Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Vlerësimi i trupit gjykues

134. Komisioni, me qëllim vlerësimin e ekzistencës ose jo të ndonjë shkakut papajtueshmërie apo konflikti interesash të subjektit në çështjen e sipërcituar, ka analizuar rrethanat e sipërpërmendura dhe dokumentacionin e paraqitur nga denoncuesi dhe nga subjekti, në raport me rastet e parashikuara shprehimisht në pikën 1, të nenit 17, të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se: “[...] Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij; b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij; c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërin prej palëve private; d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale; dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim; e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie [...]”
135. Në këto kushte, Komisioni, fillimisht, përjashton germën “e”, të paragrafit 1, të nenit të sipërpërshkruar, që i referohet rasteve të papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16 të të njëjtit Kod, për sa kohë as nuk është pretenduar nga denoncuesi ekzistenca e ndonjë rrethane që mund të përkojë me këto dispozita. Gjithashtu, vlerësohet se nuk ka elementë dyshues apo pretendime të denoncuesit lidhur me rrethana që mund të përkojnë apo përngjajnë me rastet e parashikuara në gerrat “b”, “c”, “d” dhe “dh” të po të njëjtës dispozitë, të cilat mund të kishin qenë burim detyrimi për paraqitjen e kërkesës për dorëheqje në rastin konkret, nga subjekti i rivlerësimit.
136. Lidhur me rastet e parashikuara në gerrat “a”, “ç” dhe “ë” të nenit 17, në Kodin e Procedurës Penale, trupi gjykues çmon sa vijon: (i) përjashtohet ekzistenca e interesit në bazë të germës “a”, pasi siç rezulton nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni dhe siç është pohuar edhe nga denoncuesi, marrëdhënia juridiko – civile midis palëve ishte shuar rreth dy vite më parë se të shqyrtohej çështja penale ndaj tij; (ii) gjithashtu, lidhur me gerrat “ç” dhe “ë” nuk rezulton e provuar ekzistenca e ndonjë mosmarrëveshjeje apo shtate konfliktuale, ose ndonjë shkakut tjetër, përgjatë periudhës në të cilën subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështjen penale me të pandehur denoncuesin. Ekzistenca e mosmarrëveshjes së pretenduar nga denoncuesi, në momentin e shqyrtimit të çështjes ndaj tij, jo vetëm që nuk është provuar prej tij nëpërmjet materialit të përcjellë në Komision, por gjithashtu denoncuesi ka dështuar ta provojë atë edhe

nëpërmjet kërkesës për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit, kërkesë e rrëzuar nga trupi gjykues përkatës.

137. Në këto kushte, në mungesë të provave mbi ekzistencën e ndonjë shkakut tjetër apo rrethanave konfliktuale, rrjedhëse në segmentin kohor në analizë, si dhe duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që kërkesa e denoncuesit për përjashtimin e subjektit është rrëzuar nga gjykata - përpos dakordësisë së shprehur nga subjekti për t'u larguar nga trupi gjykues - Komisioni çmon se nisur nga sa është administruar përgjatë procesit administrativ, nuk kanë rezultuar elementë të mjaftueshëm në bazë të të cilëve të mund të kristalizoheshin shkaqe dorëheqjeje nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me çështjen në fjalë.

Lidhur me denoncimin nr. * prot., datë 10.7.2019, të paraqitur sërish nga shtetasi A. Z.**

138. Denoncuesi A. Z., nëpërmjet denoncimit të dytë, përshkruan se ka qenë përfaqësues me prokurë në procesin civil me palë F. Sh. dhe D. C., etj., dhe ATK Tiranë, në seancën gjyqësore datë 29.5.2019, ku anëtare ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi pretendon se kur relatori i seancës i ka dhënë të drejtën e fjalës, ai nuk ka mundur dot të paraqesë kërkesën e tij për sjelljen jo të rregullt të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pasi kjo e fundit ka ndërhyrë duke mos e lejuar atë të flasë dhe ka filluar ta kërcënonte duke i thënë se do të bënte kallëzim penal për shpërdorim detyre etj.
139. Me qëllim verifikimin e vërtetësisë së përmbajtjes së denoncimit, Komisioni zhvilloi hetime të mëtejshme duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për vënien në dispozicion të regjistrimit *audio* të seancës gjyqësore. Nga regjistrimi *audio* rezulton se subjekti i rivlerësimit, menjëherë, pas prezantimit të trupës, bën kërkesë për tërheqje nga trupi gjykues, duke parashtruar si shkak kallëzimin penal të depozituar në Prokurori, në ngarkim të bashkëshortit të saj, z. Arenc Brahimi, nga avokati (denoncuesi).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

140. Në lidhje me këtë denoncim, subjekti, veç të tjerash, ka shpjeguar se në periudhën shtator 2018 dhe deri më sot, në të gjitha çështjet ku avokati A. Z. ka qenë apo ka hyrë si përfaqësues, në momentin që legjitimohet, automatikisht konstaton pengesën për të vazhduar gjykimin. Duke qartësuar se përpara se të marrë fjalën avokati A. Z. apo kushdo palë ndërgjyqëse për t'u shprehur në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, deklaronte shkakun dhe jep dorëheqjen menjëherë pas legjitimit të tij si përfaqësues apo pas shpalljes së trupit gjykues, në të gjitha çështjet prej shtatorit të vitit 2018 dhe deri më sot.
141. Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit aktin e parë të dorëheqjes dhënë nga prej saj në datën 19.9.2018, si dhe aktin nr. *** “Vendim për miratimin e dorëheqjes” datë 25.4.2019, të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i cili shprehet se: “[...] fakti i parashtruar prej gjyqtarës si arsye për dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje, pra, ekzistenca e një konflikti me av. A.Z., është një fakt i njohur tashmë [...]”.
142. Subjekti ka shtuar se avokati A. Z. ishte tërësisht në dijeni të faktit (që po ndodh prej dy vitesh e gjysmë tashmë), që subjekti deklaronte rregullisht dorëheqjen, në momentin që ai legjitimohet si përfaqësues në proces dhe, për rrjedhojë, nuk kishte asnjë arsye që në atë seancë të referonte ndonjë kërkesë përjashtimi. Subjekti ka paraqitur aktin e

dorëheqjes datë 19.9.2018, si dhe aktin “vendim mbi shqyrtim dorëheqjeje”, datë 25.4.2019, të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Vlerësimi i trupit gjykues

143. Komisioni, në vijim të analizës dhe të shqyrtimit të fakteve, rrethanave dhe dokumenteve të sipërpërmendura, vlerëson se edhe në këtë rast subjekti i rivlerësimit ka vepruar sipas dispozitave ligjore duke përmbyllur detyrimin për paraqitjen e dorëheqjes, si në rastin konkret, edhe në rastet e tjera të dokumentuara. Për rrjedhojë, pretendimet e ngritura nga denoncuesi, ndonëse mund të ngrehin dyshime mbi një komunikim të ndikuar disi nga ekzistenca e një situatë konfliktuale, nuk kalojnë pragun e provueshmërisë dhe besueshmërisë për të kristalizuar ndonjë mangësi në aftësitë profesionale apo përgjegjësi nën këndvështrimin e etikës së subjektit të rivlerësimit.
144. Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet e bëra nga KLGj-ja, lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit - problematikat që kanë rezultuar nuk mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale.
145. Në këto kushte, trupi gjykues, çmon se rrethanat e sipërcituara nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, si rrjedhim, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, ka arritur së paku nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit ligjor që e përcakton atë si prag kualifikimi.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, sipas parashikimit të gurmës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.
2. Transferimin e çështjes civile - me palë ndërgjyqëse: paditës A. Ç., e të paditur: Zyra Përmbartimore “****” sh.p.k., dhe me objekt: “*Kundërshtim i veprimeve përmbartimore*”, - të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, dhe të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 12.5.2015, pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 21.7.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka